



**Titulli i projektit**

Krijimi i Faqeve të Internetit të Njërive Bashkiake Mat e Klos

**Tipi i projektit**

Shërbimet Publike

**Vendndodhja e projektit**

Bashkia Mat dhe Klos,

**Buxheti i paravlerësuar**

1,000,000 lekë

**Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve**

Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njërive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhobjave bazë të synuara. Ruajtja e stadi të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Krijimi i faqeve të Internetit për aksesin në kohë reale të informacionit mbi shërbimet publike, kostot dhe rezultatet e organeve të pushtetit lokal, do të rriste transparencën dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve. Këto faqe mund të depozitoheshin dhe të mirëmbaheshin nga serverat qëndrorë, që do të krijoheshin nga sistemi i integruar i të dhënave sipas fishës së projektit Nr. 3.

**Qëllimi/et specifik të projektit**

Krijimi i Faqeve të Internetit të bashkive Mat dhe Klos dhe mirëmbajtja e tyre me informacion të përditësuar mbi shërbimet publike.

**Rezultatet e pritshme dhe treguesit**

- Krijimi i faqeve të internetit për bashkitë Mat dhe Klos (faqe efektive me komunikim direkt me serverat qëndrorë të këtyre bashkive);
- Informacion i përditësuar në faqet e internetit të bashkive (shërbimet publike të ofruara, taksat, tarifat, licencat, burimet turistike, aktivitetet kulturore, rezultatet e aktiviteteve të zyrtarëve publikë);
- Rritja e transparencës dhe llogari-dhënies së funksionarëve publikë lokalë (prezenca në faqen e internetit e planeve strategjike të zhvillimit ekonomik, planit të buxheteve vjetore dhe afatmesme, raporteve tremujore, gjashtëmujore të zbatimit të buxheteve, vendimet e këshillit bashkiak dhe planet e dëgjësave publike, rezultatet e prokurimeve dhe kontratave, rezultatet e auditimeve dhe zbatimet e rekomandimeve).

# PROJEKTI 4



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- Prezantim i konceptit dhe formatit të faqeve të internetit;
- Aprovimi dhe zhvillimi i Kodit;
- Trajnimi i personelit mirëmbajtës;
- Popullimi i faqes së internetit dhe mirëmbajtja.

## Maturimi i projektit

Aktualisht Bashkia e Burrelit ka një faqe funksionale, e cila duhet të pasurohet dhe të integrohet me informacionet që do të vijnë nga njësitë e tjera. Kodi dhe formati ekzistojnë, ndaj bëhet fjalë vetëm për pasurimin e tij.

Faqja e internetit e Bashkisë Klos mund të zhvillohej me të njëjtin koncept dhe format, duke minimizuar kostot.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Donatorët (Projekti START)
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkitë Mat dhe Klos
- Qeveria Qëndrore dhe Këshilli i Qarkut
- AKSH
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

## Kostot e projektit

Prezantim i konceptit dhe formatit të faqeve të internetit 0  
(duke u nisur nga replikimi i faqes ekzistuese të Internetit të Burrelit)

Aprovimi dhe zhvillimi i Kodit 20,000

Trajnimi i personelit mirëmbajtës 20,000

Popullimi i faqes së internetit dhe mirëmbajtja

Do të jenë pjesë e aktiviteteve të personave të punësuar për mirëmbajtjen e rrjetit të informacionit të brendshëm

Total: 40,000 lekë